



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.09/69 për ndalimin e përkohshëm të eksportit dhe riekспортit të produkteve themelore agro-ushqimore, i datës 13 prill 2022.
2. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Nisur nga përmirësimi i situatës me furnizim me produkte esenciale ushqimore në tregun e Republikës së Kosovës, lehtësimet në furnizimin me lëndë të parë për sasi të kontraktuara nga bizneset vendore; nënshkrimin e marrëveshjeve për furnizim me produkte të vajit me prodhuesit vendor nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përfshirë pranimin e Letër Zotimit të datës 22 gusht 2022 nga Shoqata e Mullisëve të Kosovës për furnizim me grurë vendor dhe nga importi drejtuar Ministres së Industrisë së Kosovës, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e në veçanti me qëllim që të mos kenë humbje bizneset prodhuese në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë